

Mire Mladenovski

Atentati në Marsejë





Pyetja kyçe

Në cilën masë atentati e zgjidhi problemin e diktaturës së Aleksandrit?



Tema

Vrasja e mbretit Aleksandër përfaqëson një ngjarje të rëndësishme në historinë e Jugosllavisë. Gjithashtu përfaqëson pikë kthyesë në jetën politike të vendit. Atentati ishte i mbuluar me një vello misteri dhe ekzistojnë teori të ndryshme për atë se kush qëndronte pas atentatit. Andaj, në të njëjtë kohë përfaqëson temë mjaft të ndjeshme dhe kontroverse. Bëhet fjalë gjithashtu edhe për çështjen e arsytimit të atentatit, si dhe për qëllimet që priteshin të arrihen me të.



Rezultatet e të mësuarit:

Kuptimi i arsyeve për vrasjen e mbretit Aleksandri I. Si u pranua nga ata që ishin të përfshirë dhe cilat ishin pritjet dhe rezultatet e atentatit.

1. Nxënësit to t'i vlerësojnë shkaqet e vrasjes së mbretit Aleksandër.
2. Nxënësit do t'i analizojnë dhe krahasojnë burimet.
3. Ata do t'a identifikojnë rëndësinë e vrasjes së mbretit për zhvillimet e ardhshme në Jugosllavi.



Qëllimet

Kuptimi kritik i natyrës komplekse të së kaluarës dhe rritja e vetëdijes për të menduarin kritik dhe qasjen multiperspektive për adresimin e ngjarjeve historike.

Udhëzimet për mësimdhënësin:

HAPI 1

Punë në grupe – Secili grup i pranon materialet e njëjta për të krijuar shiritin e kohës.

HAPI 2

Punë në grupe – analiza e birimeve dhe diskutim

HAPI 3

Punë në grupe – shkrimi i artikullit gazetaresk

Opsioni 1: shikimi i filmit për vrasjen e mbretit Aleksandri I.

Vijohet me stuhinë e ideve për temën: Atentati – mësimdhënësi i shkruan komentet kyçe nga stuhia e ideve në tabelë.

Opsioni 2:

Stuhi idesh për temën: Atentati – mësimdhënësi i shkruan komentet kyçe nga stuhia e ideve në tabelë.

Detyra është të shkruhet artikull gazetaresk që i përmban të gjitha komentet e shkruara në tabelë.

VIDEO MATERIAL I REKOMANDUAR PËR HAPIN 3:

<http://www.youtube.com/watch?v=SrruCOZwxKA>







90
minuta

Detyra 1

Cilat ishin ngjarjet më të rëndësishme politike para dhe pas atentatit ndaj mbretit Aleksandri I?

Radhiti dokumentet në bazë kronologjike!

- Cilat janë ngjarjet kryesore politike para dhe pas atentatit të mbretit Aleksandër I?
- Cilat ishin ngjarjet kryesore në jetën politike jugosllave para dhe pas atentatit ndaj Aleksandërit I?
- Detyra është të renditen me radhë kronologjike duke i krahasuar shtatë ngjarje të lidhura me Mbretërinë Jugosllave. Secila ngjarje duhet të përmbajë datë, titull, dokument të shkruar dhe burime vizuale që i referohen asaj. Është punë në grupe dhe secili grup ka detyrë të njëjtë. Më pas, secili grup do t'i prezantojë rezultatet e punës së tij përballë të tjerëve.
- Secili grup pranon materiale të njëjta për të krijuar shiritin e kohës.

Krijimi i Mbretërisë SKS	Vrasja e Stjepan Radiçit	Diktatura e 6 janarit	Vrasja e mbretit Aleksandri I
1934	1929	1918	1928
			
Mbretëria e Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve u formua në vitin 1918 nga bashkimi i shteteve provizore të Sllovenëve, Kroatëve dhe Serbëve, i formuar nga territoret e Perandorisë së shkatërruar Austro – Hungareze, me Mbretërinë e mëparshme të pavarur Serbe.	Politikani kroat dhe themeluesi i Partisë Fshatare Kroate (PFK, Hrvatska Seljačka Stranka), Stjepan Radiç, u vra në Kuvend nga politikani serb Punisha Raçiq.	Mbreti Aleksandri I u vra në Marsejë më 9 tetor 1934 bashkë me ministrin frëng të punëve të jashtme Louis Bartou, gjatë vizitës shtetërore në Francë.	Është vendosur diktatura mbretërore në Mbretërinë e Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve nga Mbreti Aleksandër. Filloi më 6 janar 1929 kur mbreti e pezulloi kuvendin dhe e morri kontrollin mbi shtetin. Emri i monarkisë u ndryshua në Jugosllavi.

Detyra 2

Si ishte situata politike në Jugosllavi para vrasjes së mbretit Aleksandri I?

Sqaroje situatën në Jugosllavi!

Sqaroje situatën politike para vrasjes së mbretit Aleksandri I.

Detyra është të analizohet situata politike në Jugosllavi në vitin 1930 nga këndvështrimi i mbretit, lëvizjes së ustashëve dhe VMRO-së (Organizatës së Brendshme Revolucionare Maqedonase). Përballë grupeve të tjera secili grup i sqaron këndvështrimet e ndryshme. I ndjekur me diskutim! Secili grup (janë 3 grupe) pranon dokumente të ndryshme.

Burimi 1

PROKLAMATA E MBRETIT ALEKSANDËR, 6 janar 1929.

...ka ardhur koha kur nuk mund të ketë dhe nuk duhet të ketë asnjë ndërmjetësues mes popullit dhe Mbretit...

Puna e parlamentit dhe jeta jonë e plotë politike po marrin konotacione gjithnjë e më tepër negative, duke mos bërë asgjë përpos dëmtimit të popullit dhe shtetit. Të gjitha institucionet e dobishme në vendin tonë, përparimi dhe zhvillimi i tyre në jetën e tërë popullit janë vënë në rrezik.

Një situatë e këtillë jo e shëndetshme në vend e dëmton jo vetëm jetën e brendshme por gjithashtu rendin dhe zhvillimin e raporteve të jashtme në vend, si dhe forcimin e reputacionit tonë dhe imazhit të jashtëm.

Parlamentarizmin, i cili si mjet politik sipas traditës së Babait Tim të paharruar, mbeti edhe ideali im, filluan ta keqpërdorin ndjenjat e verbuara politike deri në atë masë, sa që ekzistonte pengesë për çdo punë të dobishme në Shtet. Përçarjet dhe ngjarjet e pikëlluara në Kuvendin Popullor e bënë të luhatshme te Populli besimin në dobi të këtij institucioni. Marrëveshjet, por edhe raportet më të thjeshta mes partive dhe njerëzve, u bënë absolutisht të pamundura.

Në vend të forcimit të shpirtit të unitetit nacional dhe shtetëror, parlamentarizmi – siç është – i inkurajoi ndarjet nacionale. Është detyra ime e shenjtë, që me të gjitha mjetet ta rruaj unitetin Shtetëror dhe Popullor. Dhe unë jam i vendosur që këtë detyrë pa mëdyshje ta përmbushi deri në fund.

Ta rruash unitetin e popullit dhe tërësinë e shtetit, ky është qëllimi më i lartë i Sundimit Tim, ndërsa ky duhet të jetë ligji më i lartë për Mua dhe për secilin. Këtë Ma imponon edhe përgjegjësia ime para Popullit dhe para historisë. Këtë Ma imponon edhe dashuria ndaj Atdheut dhe pieteti ndaj viktimave të shumta e të çmueshme, të cilat rranë për atë ideal.

Të kërkosh ilaç në atë krim të ndryshimeve të gjertanishme parlamentare që qeverisë ose në zgjedhjet e rreja parlamentare, do të thoshte të humbësh kohë vlefshme në përpjekje të kota, të cilat na i morën disa vite të fundit. Ne duhet të kërkojmë metoda të reja të punës dhe të ecim rrugë të reja...

Prandaj kam vendosur që Kushtetuta e Mbretërisë së Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve e 28 qershorit 1921 të pezullohet. Të gjitha ligjet e vendit mbeten në fuqi, përderisa sipas nevojës nuk pezullohen me Dekretin Tim. Në mënyrë të njëjtë në të ardhmen do të sillen ligjet e njëjta. Kuvendi popullor i zgjedhur më 11 nëntor 1927 shpërndahet.

Službene novine Kraljevine SHS, 6. januar 1929.

Burimi 2

PAKTI I MARRËVESHJES BALLKANIKE, Shkurt 1934

Neni 1

Jugosllavia, Greqia, Rumania dhe Turqia garantojnë siguri të ndërsjellë të të gjitha kufijve ballkanikë.

Neni 2

Palët e larta që merren vesh obligohen të merren vesh për masat të cilat do të merren gjatë shfaqjes së rasteve eventuale të cilat mund t'i prekin interesat e tyre siç janë definuar në këtë marrëveshje. Ata obligohet që nuk do të ndërmarrin asnjë aksion politik kundër cilitdo qoftë vendi ballkanik i cili nuk është nënshkruar i kësaj marrëveshjeje, pa informim paraprak të ndërsjellë dhe nuk do të pranojë për vete asnjë obligim politik përkundër cilitdo qoftë vendi ballkanik, pa pajtim të palëve tjera të marrëveshjes.

Neni 3

...Marrëveshja do të jetë e hapur për çdo vend ballkanik bashkëngjitja e të cilit do të jetë mjet i shqyrtimit të favorshëm nga ana e palëve të marra vesh dhe do të bëhet i plotfuqishëm porsa vendet tjera nënshkruese do ta njoftojnë pajtimin e tyre.

Službene novine, 1934., br. 145-XXXVIII.

http://www.rastko.rs/istorija/diplomatija/pbs_s.html (19. 07. 2013.

Ante Paveliq ishte avokat dhe politikan në Mbretërinë Jugosllave, i njohur për besimet e tija nacionaliste, veçanërisht për Kroacinë e pavarur. Në periudhën 1927-1929 ishte anëtar i Kuvendit të Jugosllavisë, ku i shprehu besimet e tija për pavarësinë e Kroacisë. Në këtë periudhë u bënte thirrje kroatëve për revoltë të armatosur kundër Jugosllavisë, ndërsa pasi që mbreti Aleksandër e vendosi diktaturën më 6 janar (1929), Paveliq u largua në Itali ku e themeloi lëvizjen e ustashëve – Lëvizje Nacionale Kroate. Në fillim ishte lëvizje nacionaliste kroate me qëllim të krijimit të Kroacisë së Madhe të pavarur dhe kryengritje të armatosur. Në tetor të vitit 1934 ai e planifikoi atentatit ndaj mbretit Aleksandri I.



Ustashët



Ante Paveliq

Burimi 1

KUSHTETUTA E LËVIZJES ÇLIRIMTARE KROATE

...Misioni i lëvizjes: Ustashët, lëvizja çlirimtare kroate, ka për detyrë që me të gjitha mjetet – bile edhe me kryengritje të armatosur – ta çlirojë nga sundimi i huaj Kroacinë, që ajo të bëhet plotësisht e pavarur në tërë hapësirën e saj popullore dhe historike. Kur të arrihet ky qëllim, lëvizja e ustashëve me të gjitha mjetet do ta mbrojë pavarësinë shtetërore të Kroacisë dhe veçantinë popullore të popullit kroat; do të luftojë për këtë, që në shtetin kroat çdoherë të sundojë vetëm populli kroat, që ai të jetë i zoti i të gjitha të mirave materiale dhe shpirtërore në vendin e vet, të rregulluar në mënyrë përparimtare dhe të drejtë në frymën e parimeve të ustashëve...

F. ulinovi , *Dokumenti o Jugoslaviji: Historijat od osnutka zajednicke drzave do danas*, 1968,page 299.

Burimi 2

PARIMET E LËVIZJES SË USTASHËVE, Qershor 1933

Populli kroat ka të drejtë që ta rigjallërojë pushtetin e vet të lartë (soveran) në tërë Shtetit e vet Kroat në tërë popullin e vet dhe hapësirën historike, d.m.th. ta vendosë sërish pavarësinë e vet të plotë në Shtetin e Pavarur Kroat. Kjo mund të bëhen me të gjitha mjetet, bile edhe me forcën e armëve... Populli kroat ka të drejtën supreme (soveranitetin) me të cilën ai do të sundojë në shtetin e vet dhe do drejtojë me të gjitha punët e veta shtetërore dhe popullore.

Për punët popullore dhe shtetërore kroate në Shtetin e Pavarur Kroat nuk guxon të vendos askush i cili nuk është brez pas brezi dhe nga gjaku pjesëtar i popullit kroat, dhe gjithashtu nuk guxon të vendosë për fatin e popullit kroat dhe Shtetit Kroat asnjë popull i huaj, as shtet”.

http://hr.wikisource.org/wiki/Načela_Hrvatskog_ustaškog_pokreta (19.07.2013)

Burimi 3

MEMORANDUMI I AUGUST KOSHUTIQIT DHE JURAJ KRNEVIQIT DREJTUAR LIDHJES SË KOMBEVE

...Në tërë territorin shtetëror kroat është vendosur regjimi absolutist i mbretit serb, i cili popullit kroat ia shkurton të drejtat primare popullore, të cilat përndryshe i janë siguruar secilit popull. Kështu është ndaluar përdorimi i emrit të popullit kroat, i cili është i pranuar në marrëveshjet ndërkombëtare si faktor ndërkombëtar, dhe i cili nuk ka hequr dorë as nga emri i tij e as nga ekzistenca e tij në bashkësinë e popujve. Janë të ndaluara stema dhe flamuri kroat. Janë shpërndarë dhe janë ndaluar shoqatat kroate të kulturës dhe shkencës. Gjuha kroate është shtypur nga shkollat dhe shërbimet publike. Është shtrembëruar dhe është fshirë historia në librat shkollorë. Synohet të ndërpritet përparimi kulturor i popullit kroat, që të veçohen nga populli gjeneratave kroate, dhe t'u largohet e tërë letërsia e shkruar kroate. Lihet pas dore feja kroate, dhe dëmtohen varrezat (për shembull në Zagreb më 1 nëntor 1929). Territorët kroate pa vullnet janë ndarë dhe njëkohësisht i janë nënshtruar dominimit serb. Janë ndaluar emërtimet historike shtetërore, p.sh. Kroacia dhe Bosnja. Pa vullnet janë vendosur tatime dhe taksa të tjera publike të merren me forcë dhe pa kontroll shpenzohen shumica në Serbi.


Me ndihmën e forcës së pakufishme absolutiste synohet që të mënjanohet përfaqësia popullore parlamentare kroate, edhe pse ky përfaqësim – krahas përndjekjeve të ndryshme dhe dhunës – nën udhëheqjen e Stjepan Radiqit u zgjodh në të gjitha zgjedhjet e gjertanishme (28 nëntor 1920, 18 mars 1923, 8 shkurt 1925 dhe 11 tetor 1927). Pa e marrë parasysh shpirtin e popullit kroat dhe të vullnetit të tij të shprehur qartë synohet që përfaqësimi të zëvendësohet me funksionarë, të cilët popullit kroat ia kanë emëruar sipas mbretit absolut të Serbisë.

F. ulinovi , *Dokumenti o Jugoslaviji: Historijat od osnutka zajednicke drzave do danas*, 1968,page 299-300.

VMRO është organizatë maqedonase e themeluar që vitin 1893. Ideja e saj themelore ishte arritja e autonomisë në kuadër të Perandorisë Osmane, si fazë kalimtare drejt krijimit të shtetit të pavarur maqedonas. Me kalimin e kohës erdhi deri te ndarja e saj në dy pjesë: VMRO (e bashkuar) dhe VMRO (vërhoviste).



Komitët – njësitë ushtarake të VMRO-së



Ivan (Vanço) Mihailov

Përderisa VMRO (e bashkuar) synonte krijimin e shtetit maqedonas si shtet i popullit maqedonas, VMRO (vërhoviste) të cilën e udhëhiqte Vanço Mihailov synonte krijimin e shtetit të pavarur të Maqedonisë, si shtet të dytë bullgar, respektivisht shtet të popullit bullgar. Kjo solli deri te mospajtimet e mëdha mes këtyre dy organizatave të cilat e mbajnë emrin e njëjtë. Mospajtimet janë shoqëruara me vrasje dhe atentate të shumta.

Burimi 1

Unë plotësisht e kuptoj pse maqedonasit më parë flisnin për autonomi. Në atë kohë e tërë Maqedonia ishte nën pushtetin osman; sipas kësaj, kishte mundësi të ekzistojë në kuadër të shtetit të madh turk me status autonom. Megjithatë, nga vitit 1912 mundte vetëm të kërkojë pavarësi. Përndryshe do të vendosej nën pushtetin e tre anëve të ndryshme, në tre shtete të ndryshme, e ndarë si Polonia e vogël. Në atë pozitë të tillë të saj, do ta humbte tërë territorin e saj... Nuk do ta mbante emrin e saj në asnjërin prej tre pjesëve – njëri do të ishte Greqia Veriore, etj. – Serbia Jugore, etj. Lëvizja maqedonase u bashkëngjitet ideve të theksuara këtu më gjatë se gjysmë shekulli. Ata i përkrahin të gjitha qarqet çlirimtare jashtë vendit. Mendojmë se ideja për Maqedoninë e pavarur dhe paqen ballkanike duhet të jetë e pranueshme sot, kur shqyrtohet me këmbëngulje nevoja për paqe dhe bashkim në Evropë.

М . . . Б , И М , С Л , 1950

Burimi 2

Për çka bëhet fjalë?

Duket se në mes të Evropës, thuajse 48 orë me tren nga stacioni i Lionit në Paris, ekziston një organizatë e cila është më e fuqishme se shteti dhe e cila vepron në atë territor. Kjo organizatë posedon tokën e saj, gazetën e saja, policinë e saj dhe gjyqet e saja. Mbledh tatime, merr para nga jashtë vendit, dënon me vdekje sipas vlerave të saja morale. Kjo organizatë e tmerrshme sundon në mënyrë sovranë në një pjesë të vendit, dhe qeveria zyrtare nuk bën as politikë të brendshme as të jashtme e cila nuk është në pajtim me kuptimet e kësaj organizate. Kjo e ka detyruar Jugosllavinë të vendosë tel me gjemba në kufi dhe ti vendos nën roje hekurudhat dhe urat sikur të jetë në gjendje lufte. Këto dhe gjerat e ngjashme i bën Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase – VMRO.

Алберт Лондр, Комитации, Тероризмот на Балканот, Скопје, Култура, 1996

Burimi 3

Bashkëpunimi me lëvizjen e ustashëve

Në prill të vitit 1929 Komiteti Nacional Maqedonas nën kontrollin e Mihajllorit dhe përfaqësuesi kroat nënshkruan Deklaratë për bashkëpunim për krijimin e Shtetit të Pavarur Kroat dhe Maqedonisë së Pavarur, si shtet i dytë bullgar. Me aksionin e përbashkët të forcave kroate dhe maqedonase, më 09.10.1934 është kryer atentat ndaj mbretit të Jugosllavisë Aleksandër Karagjorgjeviq. Qeveria Bullgare, në krye me Kimon Georgievin, në fund të vitit 1934 vendosi ta shpërndajë VMRO-në, pas së cilës kjo nën udhëheqjen e Mihajllorit vazhdoi të vepronte jashtë shtetit. Ishin në lidhje me nazistët dhe forcat profashiste në Gjermani, Itali, Hungari dhe Kroaci dhe vepronin deri në fund të Luftës së Dytë Botërore.

Зоран Тодоровски, ВМРО 1924 - 1934, Скопје, 1997

1. Sqaroi qëllimet dhe ideologjinë e lëvizjes së ustashëve!
2. Sqaroi qëllimet dhe ideologjinë e lëvizjes së VMRO-së!
3. Theksoi ngjashmëritë dhe dallimet mes këtyre dy lëvizjeve!

Detyre 3

“Kush e vrau”
Mbretin Aleksandëri
I?

Shkruaj një artikull! – “Kush e vrau” Mbretin Aleksandëri I?

Fillojmë me shikimin e filmit të shkurtër për vrasjen ose me “stuhi idesh” për vrasjen e mbretit Aleksandëri I. Secili grup fiton rol të caktuar të gazetareve të cilët informojnë për vrasjen e mbretit Aleksandëri I. Artikulli duhet të përmbajë edhe parashikim për pasojat të cilat mund të vijojnë pas vrasjes (luftë, demokraci, diktaturë të re...).

Rolet e mundshme janë si në vijim (secili mësimdhënës në mënyrë të pavarur i zgjedh rolet...):

-Gazetar i cili shkruan për gazetën ndërkombëtare (p.sh. franceze, gjermane...);

-Gazetar i cili shkruan për gazetë nga Serbia;

-Gazetar i cili shkruan për gazetë nga Kroacia.

Pas mbarimit të kësaj detyre, lexohen artikujt dhe jepen komente për përmbajtjen e tyre, nëpërmjet gjetjes së ngjashmërive dhe dallimeve dhe arsytet për këtë.

Secili grup (janë 3 grupe) fiton komplet të njëjtë të dokumenteve.

Burimi 1

...Mbreti Aleksandri I është vrarë në Marsejë më 09.10.1934 bashkë me ministrin e punëve të jashtme të Francës Luj Bartou, gjatë vizitës zyrtare në Francë. Mbreti Aleksandër udhëtoi në Francë me qëllim të forcimit të aleancës mbrojtëse kundër Gjermanisë naziste. Vrasja e mbretit e tronditi thellë tërë Jugosllavinë, ndërsa qindra mijëra njerëz erdhën t'ia japin respektin e fundit gjatë kortezhit të verimit përgjatë vendit, deri te varrezat mbretërore në Oplenc. Mbreti Aleksandri I është varrosur në mauzoleun e kishës Shën Gjergji të cilën e ka ndërtuar Petari I. Në shenjë mirënjohjeje për arritjen e tij më të madhe, Kuvendi Popullor dhe Senati i Mbretërisë Jugosllave e shpallën atë Mbreti Aleksandri IV Bashkuesi.

Službena internet stranica Srpske kraljevske porodice, http://www.royalfamily.org/index.php?43.en_hm-king-alexander-i-of-yugoslavia (19.07.2013).

Burimi 2

Si e shihte Marseja ngjarjen e 9 tetorit 1934, nga Simon Misirliq, korrespondent i “L’ Illustrasion”.

“Marseja shkëlqente në gëzim të përgjithshëm, e stolisur me flamuj trengjyresh me ngjyra të njëjta – e kaltër, e bardhë dhe e kuqe. Të renditura horizontalisht, ngjyrat e përfaqësojnë flamurin jugosllav, ndërsa ngjyrat e njëjta të vendosura vertikalisht, përfaqësojnë flamurin frëng. Me to ishin zbukuruar jo vetëm rrugët në qendër të qytetit, por edhe paralagjet ishin zbukuruar. Ishte ajo dita e gëzimit në disponimin tipik mesdhetar, të gjithë ishin të gëzuar. Restorantet në rrugën kryesore të Marsejës, në Avenynë Kanabijer dhe në rrugët përreth i mbushte një masë e zhurmshme dhe e gëzuar e njerëzve. Ndërsa përgjatë gjithë rrugës së paraparë mbretërore – nga limani i vjetër deri te Përmendorja e Luftëtarëve të frontit të Selanikut – dritaret dhe ballkonet ishin të mbushur plot njerëz, gra, fëmijë.

Gazeta franceze “Illustrasiona”, 09.10.1934.

Burimi 3

Hrvoje Matković e paraqet Vllado Çernozemskin si maqedonas

Si udhëheqës kryesor të grupit të atentatorëve Paveliq e vendosi Eugen Didu Kvaternikun. Atentatorët përgatiteshin në vendin Janka Pusta, në Hungari, dhe me pasaporta të rreme të Austrisë dhe Zvicrës arritën në Francë. Në Zvicër iu bashkëngjitën Dido Kvaternikut, i cili ishte në ndjekje të anëtarit maqedonas të OBRM-së (Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase), të quajtur “Vllado shoferi”. Sidoqoftë OBRM-ja mbante raporte të mira me organizatën e ustasëve për shkak të qëllimit të përbashkët – shkatërrimin e Jugosllavisë. Për këtë arsye (OBRM) i dërgoi anëtarët e saj si instruktorë të aksioneve guerile. “Vllado shoferi” ishte njëri prej tyre..

Povijest Jugoslavije : 1918-1991 : hrvatski pogled, 1998. Naklada Pavičić

Izvor 4

Heronj dhe vrasës

Kroatët nuk kishin përvoja me aktivitetet e komplotit. Për këtë arsye shprehën mirëseardhje për ndihmën e vëllezërve të tyre maqedonas, të cilët tanimë gjysmë shekulli jetonin dhe luftonin në atmosferën e terrorit dhe komplotit. Kur Ante Paveliq e vizitoi Bullgarinë në vitin 1929, shkoi në Maqedoni që të takohet me Ivan Mihaillovin. Të dy udhëheqësit i përshëndetën ngrohtësisht dhe u ulën për t'i shqyrtuar detajet e luftës së përbashkët kundër mbretit Aleksandër. Paveliq e luti udhëheqësin maqedonas që t'u 'huazojë' ustasëve terroristë dhe konspiratorë elitare. Njëri prej atyre të cilin Mihaillov e dërgoi ishte edhe vrasësi i ardhshëm i mbretit Vlladimir (Vllado) Georgiev Çernozemski. Ai ishte njëri prej vrasësve të preferuar të Mihaillovit, sepse me sukses kishte kryer një numër të madh të detyrave. Më 15.07.1932 Mihaillov e përqafoi Çernozemskin me rastin e përshëndetjes. “Tani shko te vëllezërit tanë kroatë”, i tha. “Lufta është e njëjtë, vetëm fronti i ndryshëm. Armiku është i njëjtë”.

C X :X ,1936.

Burimi 5

Në kujtimet e tija Ivan Mihajlllov ka shkruar se Vllado Çernoziemskin e ka njohur në vitin 1922, dhe se emri i tij i vërtetë është Veliçko Georgiev Kerin. “Vllado ishte i qetë dhe njeri jashtëzakonisht efikas. Nuk i donte njerëzit që pinë. Nuk i donte gratë. E donte vetminë dhe lexonte shumë. Deri në përsosmëri e njihje historinë e Vasil Levskit dhe Hristo Botevit (revolucionarit bullgar). Ishte nacionalist.”

: M Б , 1950.

Burimi 6

Më 9 tetor 1934, në Stamboll, Turqi, në shtëpinë e mitropolitit bullgar Andreja Veliçki, pas drekës dolëm në turrasë që ta pimë kafënë e pasdites. Rreth orës 4 pasdite Mihaillov e shikoi orën dhe tha: “Në këtë moment ka ndodhur diçka që do të jetë fatale për njerëzimin! Ka nisur llogaritja e re e kohës. Fillon kalendari i ri, kalendari... i Luftës së Dytë Botërore!”

Петър Япов, Пътуване из дневниците на митрополит Андрей, глава на задграничната Българска православна църква, Ню Јорк, 1937-1972, Марскилскиятатентат с участието на Ванчо Михайлов и ВМРО 9 октомври 1934, Софија, 2002, 19.

Burimi 7

Për nder të mbretit Aleksandër, letër nga Nikolla Teslla redaktorit të gazetës “Nju Jork Tajms”



Është folur shumë për Jugosllavinë dhe popujt e saj. Megjithatë, shumë amerikanë kanë pasqyrë të gabuar për atë, sepse agjitorët dhe armiqtë politikë përhapin thashetheme për Jugosllavinë dhe banorët e saj, të cilët u takojnë popujve të ndryshëm, ndërsa të gjithë bars e urrejne pushtetin tiran i cili i mban bashkë kundër vullnetit të tyre. E vërteta është se të gjithë jugosllavët – serbë, sllavonas, hercegovas, dalmatinas, malazezë, kroatë dhe sllovenë, i takojnë racës së njëjtë, e flasin gjuhën njëjtë dhe i ndajnë idealet dhe traditat e përbashkëta.

Pas Luftës së Parë Botërore mbreti Aleksandër i ofroi unitet politik vendit dhe krijoi shtet të pasur dhe të fuqishëm. Sllovenët u pritën me entuziazëm, por njerëzve u duhej kohë që t’u përshtaten rrethanave të reja. Unë kam lindur në Kroaci. Kroatët dhe sllovenët asnjëherë nuk kanë pasur mundësi të luftojnë për pavarësinë e tyre. Serbët ishin të vetmit që kishin luftuar më shumë për liri, dhe çmimin e pagua me gjak serb. Të gjithë sllovenët dhe kroatët e ndershëm këtë e kujtojnë me falënderim. Ata janë gjithashtu të vetëdijshëm që serbët kanë aftësi dhe përvojë më të madhe për luftë, dhe që janë më të mirë dhe më të vullnetshëm që t’i dërgojnë trupat e tyre në kohë krize për shtetin.

Pasi që mbreti Aleksandër e bashkoi Jugosllavinë, filluan sulmet e kundërshtarëve politikë të cilët bënë çdo gjë që ta shkatërrojnë, duke e mbjellë farën e përçarjes dhe duke përhapur thashetheme dashakeqe...

Nikolla Teslla, Nju Jork, 19 tetor 1934

Izvor 8



I njohur me emra të ndryshëm:

- Vllado Çernoziemski
- Vllado “shoferi”
- Veliçko Dimitrov Kerin
- Vllado Georgiev

Pasaporta false e Vllado Çernoziemskit

Vllado Çernoziemski me uniformë të ustashëve

Burimi 9

VRASËSI I ALEKSANDËRIT ËSHTË TERRORIST FAMËKEQ

Vrau një numër të madh të atyre që cilët e kundërshtonin pavarësinë e Maqedonisë


Vjenë – (AP) – Ambasada jugosllave këtu ka zbuluar që emri i vrasësit të mbretit Aleksandër nuk është Petar Kaleman, por Vllado Georgiev Çernozemski, terrorist famëkeq maqedonas dhe roje e dikurshme personale e Ivan Mihajllovit, udhëheqësit revolucionar maqedonas, tani në emigracion.

Zyrtarët e ambasadës thanë se maqedonasi e shfrytëzonte emrin Kaleman si nofkë. Ata deklaruan që ai (Çernozemski) ka vrarë një numër të madh të atyre që e kundërshtonin pavarësisë e Maqedonisë. Thuhet që ai e ka vrarë Haxhi Inovin, udhëheqësin bullgar të agrarit në vitin 1921...

...Sipas burimeve bullgare, në vitin 1932 Çernozemski është angazhuar si korrier i mesazheve të fshehta të revolucionarëve maqedonas dhe terroristëve kroatë në emigracion. Kohë më parë ka punuar si instruktor në kampin në Hungari, ku, sipas pohimeve të jugosllavëve, kroatët janë trajnuar që të përdorin bomba dhe pushkë.

Çernozemski lindi në Kamenicë, në jug të Bullgarisë. Është identifikuar, siç është informuar, duke iu falënderuar fotografive të cilat policia franceze i ka marrë nga dy maqedonas jugosllavë të cilët tani jetojnë në vendlindjet e tyre, dhe me të cilët ka qenë i lidhur më herët Çernozemski.

<http://trove.nla.gov.au/ndp/del/article/10962918>



Burimi 10

Vrasësi “Vllado shoferi” është liruar dy vjet më parë që të bëhet instruktor në Janka Pusti Sofje, 19 tetor (me anë të telefonit)

Kush e di për çfarë arsyeje, në lidhje me vrasësin nga Marseja Vllado Georgiev Çernozemski këtu lëshojnë versione të ndryshme. Njëri prej tyre është lajmi për një gjoja shmangie të Vllado shoferit nga VMRO-ja pas vitit 1932. Tjetra është se ai pas vitit 1932 është vrarë nga VMRO-ja. Tani megjithatë është konstatuar se këto dezinformime janë shpërndarë në mënyrë tendencioze, që t'i fshihen gjurmët pas vitit 1932. Gjegjësisht, ai atëherë thjesht është dërguar të shërbejë si instruktor në Janka Pusti.

Siç është e njohur, që në prill të vitit 1929, në Sofje, përfaqësuesit e terroristëve nga Janka Pusta me komitetin e atëhershëm nacional, nën udhëheqjen e Dr. Stanishevit nënshkruan një marrëveshje. Kjo marrëveshje e atëhershme e tyre atëherë është publikuar në formë të deklaratës me nënshkrimet e të dyja palëve. Të njëjtat synime, metoda dhe qëllime të punës të të dyja grupeve ishin theksuar disa herë në shtyp dhe në biseda.

Politika, 19 tetor 1932



Burimi 11

Vrasësi, terrorist bullgar
Titull i gazetës ditore “Winnipeg free Press”
Kanadë

